



GENEO

Dritare për shtëpi perfekte

» Dizajni i një shtëpie nuk duhet të ndjekë kurrë modën, por **stilin e banorëve të saj**. «

-
- › GENE0: **mundësi e përshtatshëme** për arkitektët përmes formave individuale
 - › dritare të rrumbullakta të pjerrëta apo trekëndore si dhe konstruksione të dala fillimisht **realizohen me armim të plotë**
 - › Sipërfaqe e përfunduar High-Definition-Finishing (HDF) për **pamje tepër elegante**
-



KREATIVITET PA KUFIJ

Zgjedhje e lire në forma, ngjyra dhe dimensione

Bëni pjesë tek ai grup njerëzish që pretendimi i të cilëve nuk përmbushet me funksionalitet perfekt, përkundrazi ky është vetëm fillimi? Nuk kërkoni vetëm cilësi të lartë dhe dizajn brilant, por edhe një stil individual që natyrisht i përshtatet personalitetit tuaj?

Shumë shpejt do ta kuptoni arsyen pse dritaret GENEÓ janë kaq atraktive për arkitektët dhe ndërtuesit, sepse dritaret GENEÓ dhe forma e tyre nuk vendos kufij për kreativitetin e arkitektit tuaj.

GENEO është aq fleksibël sa edhe idetë që mund t'ju lindin, ju vetë ti bëni realitet pa asnjë problem - nga dritaret me madhësi e sipërfaqe maksimale deri tek format e veçanta si cepat, pjesët anësore apo format e rrubullakëta. GENEÓ bën të mundura dëshirat tuaja – dhe me funksionalitet perfekt.

Edhe përsa i përket ngjyrave, GENEÓ ju ofron të gjithë lirinë e mundshme:

Përdorni më shumë se 40 fletë laminate dhe mbi 170 ngjyra RAL për lyerje ose i jepni formë dritares suaj, me skeletët e aluminit sipas imagjinatës suaj.

Më mirë do të ishte ta provonit menjëherë (Nuk do të zhgënjeheshit)


www.rehau.de/geneo-design

Më shumë informacione mbi të dhënat teknike të dritareve tona

GENEO mund ti gjeni

në faqet 13–16





DO TË KENI STILIN TUAJ INDIVIDUAL
Jepini liri kreativitetit tuaj


KËNAQËSIA E VËRTETË

Çdo ditë, për një kohë të gjatë

Konstruksioni i kornizave me materiale të një teknologjie të lartë RAU-FIPRO i bën dritaret GENE0 të jenë aq të lehta dhe stabile sa pothuaj në të gjitha rastet përdorimi i armimit metalik nuk është i nevojshëm. Hapja dhe mbyllja kthehet në një lojë fëmijësh. Sipërfaqet e lëmuara me material cilësor lehtësojnë pastrimin dhe janë shumë rezistente ndaj kushteve atmosferike.

Që të ndiheni mirë në shtëpinë tuaj, rolin kryesor e luan temperatura e duhur e ambientit. Për këtë kujdeset sistemi i ngrohjes REHAU i cili komandohet nga rregullatori Nea. Por ai bën më shumë se kaq: Nea bëhet edhe më bindëse me dizajnin e saj, i cili ka fitur edhe çmime, me montimin e thjeshtë, me përdorimin e thjeshtë edhe për një fëmijë si dhe me funksionet e shumta. Ai ka marrë çmimin Red Dot Design për vitin 2013.






REHAU rregullatori i dhomës Nea

Komandoni temperaturën e dhomës fare thjeshtë dhe pa u munduar, me një pjesë të dizenuar.

JETË MË E LEHTË
Çdo ditë

» Një **shtëpi e mirë** punon për
pronarin e asaj shtëpie —

dhe jo e kundërta. «





-
- › GENE0 ju ul shpenzimet e ngrohjes
 - › izolim i shkëlqyer përmes modulit termik të integruar
 - › i çertifikuar edhe për shtëpitë pasive
-



NDJESI MAKSIMALE

Pa ura ngrohëse, nxehtësia mbetet në shtëpi



IZOLIM OPTIMAL

Kurseni energji deri në 76 %*

Përsa i përket kursimit të energjisë, lëreni këtë product revolucionar të teknologjisë së lartë të punojë për ju: RAU-FIPRO është sekreti i një izolimi optimal. Materialet me fibra shumë stabile – ky lloj materiali është i njohur në industrinë e ndërtimit të avionëve dhe në atletikë – bëjnë që kornizat GENE0 të përdoren pa armatim metalik në 90% të rasteve. Kështu urat e papërshtatshme të nxehtësisë as që krijohen. Dhe e kombinuar me një izolim të trefishtë do të arrini vlera U_w -shembullore deri në $0,60 \text{ W/m}^2\text{K}$.

GENEO varianti i shtëpisë pasive është çertifikuar zyrtarisht nga instituti Shtëpia pasive. Dhe subvencioni juaj nga KfW është një formalitet i pastër.

* Reduktimi i humbjeve të energjisë përmes dritares duke ndërruar dritaret e vjetra prej druri apo plastike të viteve 1980 ($U_f = 1,9$; $U_g = 3,0$) me dritare me profil GENE0 ($U_f = 0,86$; $U_g = 0,5$), dimensionet e dritares $123 \times 148 \text{ cm}$

» Një shtëpi duhet **të rezistojë gjatë** —
mire nëse **materiali**
i paraprin kohës së vet. «

-
- › Materialet me fibra të lidhur gjenden tek avionët modern, makinat e garave dhe dritaret GENE0
 - › RAU-FIPRO mundëson stabilitet maksimal tek peshat më të vogla
 - › materiali i teknologjisë së lartë kujdeset për përdorim të thjeshtë dhe izolim perfekt
-




KËTU KEMI MË SHUMË PËR JU

Teknologjia më moderne për rezultate optimale

Thjeshtë kursim energjie: me vlera U shumë të ulëta.*

| Izolim i ngrohjes qelq = U_g -Wert | Izolimi i përgjithshëm i elementëve të dritares = U_w -Wert | | |
|--------------------------------------|---|--|--|
| | GENEO Standard Korniza e izolimit të nxehtësisë = $U_i = 0,98 \text{ W/m}^2\text{K}$ Vlera psi (korniza) = 0,04 | GENEO përfshirë modulet termikë Korniza e izolimit të nxehtësisë = $U_i = 0,86 \text{ W/m}^2\text{K}$ Vlera psi (korniza) = 0,04 | GENEO shtëpi pasive e certifikuar Korniza e izolimit të nxehtësisë = $U_i = 0,79 \text{ W/m}^2\text{K}$ Vlera psi (korniza) = 0,03 |
| 0,9 W/m ² K | 1,0 W/m ² K | 0,98 W/m ² K | 0,94 W/m ² K |
| 0,8 W/m ² K | 0,96 W/m ² K | 0,92 W/m ² K | 0,87 W/m ² K |
| 0,7 W/m ² K | 0,89 W/m ² K | 0,85 W/m ² K | 0,80 W/m ² K |
| 0,6 W/m ² K | 0,82 W/m ² K | 0,78 W/m ² K | 0,74 W/m ² K |
| 0,5 W/m ² K | 0,75 W/m ² K | 0,72 W/m ² K | 0,67 W/m ² K |
| 0,4 W/m ² K | 0,69 W/m ² K | 0,65 W/m ² K | 0,60 W/m ² K |

* Sa i përket portofolit të dritareve REHAU ** shihni faqen 11



76 Prozent
Energieeinsparung**

Përdorim i lehtë, mirëmbajtje e lehtë.


Falë sipërfaqeve cilësore HDF, ndotjet pastrohen shpejt dhe thjeshtë me solucione normale. Për mirëmbajtje nuk nevojitet më shumë sesa, herë pas here të hidhni disa pika vaj mbi pjesët e lëvizshme dhe një shufër silikon për mirëmbajtjen e nevojshme për guarnicionet.

Koncepti i ri i izolimit kujdeset për presion mbyllës optimal. Duke qënë se GENEO përgjithësisht nuk duhet të përforcohet me metal, pesha e menteshave është ndjeshëm më e lehtë se tek dritaret e tjera dhe përdorimi është shumë here më i lehtë.



Gjeni qetësinë – me një lëvizje dore

Ju shqetëson zhurma – me kalimin e kohës ndikon madje edhe në shëndetin tuaj. Me GENEO dhe me vlerat e paarritura më parë në klasën 5 të mbrojtjes ndaj zhurmave ju do të keni një komoditet më të lartë.



*** Baza e llogaritjes: Rritje e akustikës me 10 dB = dyfishim i volumit të perceptuar në varësi të secilit (LfU). GENEO redukton zhurmën me 47 dB.




24 fache
Lärmreduktion***

RAU-FIPRO: TEKNOLOGJIA E TËRHEQJES

Materialet e përforcuara me fibra lehtësojnë dritaret dhe konstruksionet e tyre

Sipërfaqet e mëdha të dritareve dhe dizajni modern kërkojnë materiale të lehta dhe njëkohësisht stabile. Merrni në shtëpinë tuaj teknologjinë e lartë të aeroplanit! RAU-FIPRO është një material me fibra i një teknologjie të lartë. Ai përbëhet nga dy komponentë të ndryshëm: nga materiali bazë dhe nga materiali i përforcuar me fibra. Ndërveprimi i dy materialeve përbërëse përmirëson ndjeshëm vetitë e përgjithshme të materialit të ri. RAU-FIPRO cilësohet për stabilitet shumë të lartë – dhe kjo i ndihmon jashtëzakonisht arkitektët për të të realizuar idetë e tyre në dizenjot elegante.



Peshë e lehtë me fibra forcues.

Materiali Hightech RAU-FIPRO i jep profileve stabilitet të jashtëzakonshëm – pa mbipeshë të rrezikshme. Në 90 % të rasteve të përdorimi GENE0 përdoret pa armatime metalike të rënda. Kështu jo vetëm që dritaret janë të lehtë në përdorim por eliminon edhe urat e dëmshme termike dhe ruhet izolim optimal termik – edhe kur menteshat e dritareve janë shumë të mëdha.




Ekstra hermetike, e lehtë për tu hapur.

Tre shtresa izolimi njëra pas tjetrës përmirësojnë cilësinë e izolimit. Materiali shumë elastik dhe rezistent në kohë dhe ngarkesë garanton jetëgjatësi. Koncepti i ri i izolimit bën që njëkohësisht që presioni i mbylljes të jetë optimal. Kështu forca që ju nevojitet për të hapur dhe mbyllur dritaren reduktohet ndjeshëm.



Fleksibël sipas planit.

Profilet GENE0 janë të pajisur me kllapa funksionale fleksibël, të cilat optimizojnë përdorimin e dritares sipas rastit. Tek izolimi në rastin e shtëpive pasive përdoren për shembull modulet termike.




Teknikë e brendshme, dizajn i jashtëm.

Mbi strukturën bazë me fibra të përforcuar prej RAU-FIPRO gjendet sipërfaqja HDF (High Definition Finishing). Ajo është shumë e lëmuar, rezistent ndaj ndotjeve, pastrohet lehtë dhe ka optikë perfekte.







» Duke qenë se edhe **dritaret**
kanë krahë, frymëzimi im
është **konstruksioni i një**
aeroplani. «



Siguri e lartë pa kompromis.




Edhe pa armim metalik shtesë GENE0 arrin klasën e rezistencës RC 2, kjo falë **materialeve stabile me fibra RAU-FIPRO** me klasë rezistence RC 2. Dhe kjo me izolim të plotë të nxehtësisë. Sipas dëshirës ju mund të bëni edhe një armim shtesë.



Shijoni lirinë e kreativitetit: me forma dhe ngjyra të panumurta.

- liri arkitektonike përmes formave individuale, p.sh. dritare të rrumbullakta apo trekëndore si dhe konstruksione të pjerrta apo të dala – fillimisht realizohen me armim të plotë
- variante të larmishme formash me ngjyra brilante duke përdorur letrat dekorative, bojrat apo shablonet e aluminit
- pjerrtësi 20° dhe distancë anësore dhe 5-mm për optikë elegante
- Mundësi ekstra përsa i përket formave duke përdorur krahët e pjerrët apo ato të rrumbullakët



Dru



Sierra Winchester XA Eiche hell 1 Golden Beech Oregon Lis i errët 1



Golden Oak Dru qershie Qershie e hapur Dru qarshie fshati Macore Qershie e butë Lis moçali

Alu



Alux (Aluks)DB 703 Antracit Aluks Aluminium i kaluar me furçë

220 Farben
Unzählige Formen

www.rehau.com/de-de/private-bauherren

» Madhësia e një shtëpie nuk matet vetëm me metra katrorë — por edhe me **madhësinë e dritareve.** «

-
- › Elementë të mëdhenj me profil të hollë për ndriçim optimal dhe depërtim të rrezeve të diellit si dhe arkitekturë moderne
 - › Elementë të lartë për të mundësuar funksion të sigurt
 - › Thellësia e montimit të elementëve: 86 mm
-





HAPËSIRA E LIRË ËSHTË PUNË PRECIZE

Diçka e sigurt ka nevojë për një hapësirë të caktuar

Aty, ku të tjerët arrijnë limitet e veta, GENEØ hap rrugë të reja. Falë stabilitetit të madh të RAU-FIPRO dhe materialit me fibra në zonën e dritares, këto të fundit mund të projektohen dhe realizohen me bujari. Profilët e holla lejojnë më shumë pamje dhe rrisin sipërfaqen e

panoramës suaj. Doreza me shinë që zë shumë pak vend ose sistemet e dyerve me shinë paralele krijojnë më shumë dritë në ambientet tuaja dhe bëjnë që atmosfera e këtyre ambienteve të jetë edhe më mikëpritëse.





» Shtëpi do të thotë **mbrojtje**
për njerëzit — madje edhe **nga**
zhurmat e pa dëshiruara. «

-
- › vendos standarde të reja për izolimin ndaj zhurmave
 - › armimi metalik nuk është i nevojshëm
 - › mbron shëndetin tuaj, pasi zhurmat mund të dikojë në shëndetin tuaj
-



RELAZZO Parket taracash

Pamja natyrale e parketit me avantazhet e materialeve moderne. Zgjidhja me WPC që mirëmbahet lehtë për ata që kërkojnë më shumë.

DHOMA PERSONALE ME IZOLIM NDAJ ZHURMAVE

Projektoni shtëpinë tuaj, duke i lënë zhurmat jashtë

Krijoni një ambient të mbrojtur ku të keni mundësi të çlodheni dhe të harroni plotësisht stresin e ditës. Me GENEØ keni mundësi ta planifikoni në atë mënyrë shtëpinë tuaj që të mund të gjeni në çdo moment qetësinë që dëshironi. Edhe nëse banoni afër një rruge me shumë lëvizje, në afërsi

të një aeroporti apo pranë një stacioni trenash apo edhe nëse thjeshtë jeni i apasionuar pas një hobi të zhurmshëm – GENEØ ndalon zhurmat e padëshiruara.




TEKNIKA GODET ZHURMAT

Nuk ka rëndësi nga vijnë zhurmat – ju keni qetësinë

Falë xhamit me tre shtresa dhe profileve RAU-FIPRO, GENE0 arrin vlerat më të mira aktuale REHAU të klasës 5 të izolimit ndaj zhurmave*. Edhe në rastin e ngritjes së një avioni, ajo që ju do të dëgjoni nuk është më shumë se një pëshpërimë. Pyesni prodhuesin e dritareve tuaja.

* vlera e parapare e izolimit nga zhurma për dritaret (45–49 dB), qelq 50 dB, RwP 47 dB



E BUKURA DUHET TË MBROHET
Siguroni në mënyrë individuale pasurinë tuaj





REHAU

**Rregullatori i ambientit
Nea Smart**

Për rregullimin e
temperaturës – me anë te
pajisjeve lëvizëse bartëse



REZISTENCA NGA JASHTË

Deri në klasën e rezistencës RC 3

Kontrolli konfirmon: Asgjë nuk i tmerron aq shumë hajdutët sesa koha që humbin kur hapin dritaret. Ndërkohë që dritaret pa izolim ndaj forcave të jashtme hapen brenda një sekonde, ndërsa dritaret GENE0 të pajisura me izolimin më të fundit kërkojnë minuta të vyera për tu hapur. Edhe pa përdorimin e metalit RAU-FIPRO është aq i fortë sa të gjitha dritaret GENE0 e kanë kaluar klasën RC 2 pas testit të „ift Rosenheim“.

Falë pjesëve të veçanta të bravave dhe masave ekstra të sigurisë me sistemin GENE0 secila dritare mund të izohet në mënyrë individuale – në varësi të llojit të izolimit që ju dëshironi. Në rast nevojë apo dëshire, klasa RC 3 e sigurisë mund të zbatohet pa problem nga masat përkatëse shtesë. Konsulencë të specializuar do të gjeni tek prodhuesi i dritareve tuaja ose tek rajoni policor i vendit ku banoni.



Keni interes për GENE0? Ju informojmë me kënaqësi!

© REHAU AG + Co
Rheniumhaus
95111 Rehau

Ndryshimet teknike të kryera
980720 04.2015